

Obstetrikë (Ostetricia)

Analgjezia në lindje (Analgesia nel travaglio)

ÇFARË ËSHTË DHE PSE BËHET (Cos'è e perché si fa)

ULSS 2 | Analgjezia në lindje

Perceptimi, menaxhimi dhe toleranca ndaj dhimbjes gjatë lindjes janë faktorë jashtëzakonisht subjektiv.

Për disa gra, dhimbja mund të jetë një ngjarje shumë negative dhe, nëse është intensive, e zgjatur ose psikologjikisht i papranuar, mund të prodhojë efekte negative në mirëqenien e nënës dhe fëmijës.

Analgjezia në hapësirën epidurale konsiderohet metoda më efektive për ta luftuar atë.

CFARË ËSHTË? (Cos'è?)

Është një metodë që synon zvogëlimin e dhimbjes që ndodh natyrshëm gjatë lindjes përmes përdorimit të barnave analgjezike.

Procedura përfshin futjen e një gjilpëre në hapësirën ndërvertebrale lumbare. Më pas përmes gjilpërës futet një kateter shumë i hollë me material plastik të butë, përmes së cilit administrohen barnat.

CILAT JANË PËRFITIMET? (Quali sono i vantaggi?)

Analgjezia epidurale prodhon reduktimin e dhimbjes gjatë lindjes, duke mbajtur të pandryshuar ndjeshmërinë e lëkurës dhe ndjesinë e tkurrjes dhe shtytjes. Do të jeni të vetëdijshëm dhe të relaksuar, do të jeni në gjendje të ecni dhe të bashkëpunoni me maminë, duke marrë pjesë aktive në lindje.

KUJT KRYEJHET? (A chi si esegue?)

Për gratë që dëshirojnë të lindin në mënyrë aktive me ndihmë në kontrollin e dhimbjes, përveç rasteve kur ka kundërrindikacione, si p.sh., çrregullime të koagulimit, infeksione të rënda, prania e tatuazheve të gjera në zonën e mesit ose kushte të veçanta obstetrike.

Mund të rekomandohet tek gratë me patologji të tilla si obeziteti, hipertensioni, diabeti, disa sëmundje të zemrës dhe miopi të rënda, subjekte që janë më të rrezikuar nga komplikimet gjatë stresit të lindjes.

KUR BËHET? (Quando si esegue?)

Me dëshirën tuaj, në çdo kohë të lindjes aktive, mund të kërkoni që të kontaktohet anesteziisti i cili vendos kateterin dhe kryen administrimin e parë të barnave. Më vonë mund të kërkoni administrime të mëtejshme të boluseve analgjezike, duke zgjatur kështu kontrollin e dhimbjes për të gjithë kohëzgjatjen e lindjes, sipas nevojave tuaja.

Nëse është e nevojshme të kryhet seksioni cezarian, prania e kateterit mund të shfrytëzohet duke administruar një dozë anesteziqe të barnave.

A KA EFEKTE ANËSORE? (Ci sono effetti indesiderati?)

- Ndonjëherë mund të ketë kruajtje të përhapur (e tolerueshme dhe gjithmonë kalimtare) dhe një rritje modeste të temperaturës (veçanërisht në lindjen e zgjatur).
- Punksioni aksidental i dura mater gjatë manovrës së vendosjes së kateterit epidural është shumë i rrallë. Mund të sjellë një dhimbje koke intensive, por beninje dhe kalimtare. Kjo mund të ndërhyjë në jetën tuaj normale në ditët e hershme pas lindjes dhe për këtë arsye mund të jetë e nevojshme zgjatja e shtrimit në spital. Vetëm shumë rrallë kërkon masa të mëtejshme terapeutike përveç pushimit.
- Komplikacioni serioz neurologjik (hematoma epidurale) është një dukuri e përshkruar si e mundur, por aq e largët sa të konsiderohet një ngjarje e jashtëzakonshme.
- Ekziston mundësia e dështimit në kryerjen e procedurës, gjë që mund të ndodhë nëse ka ndryshime anatomike të shtyllës kurrizore, obezitet ose në rast të bashkëpunimit të dobët të lindës. Në këto raste, mund të merren parasysh opsione të tjera farmakologjike.

A ËSHTË E RREZIKSHME? (È pericoloso?)

Jo. Nuk është e rrezikshme për ju ose për fëmijën. Përkundrazi, mund të kontribuojë në mirëqenien tuaj gjatë lindjes.

A ËSHTË E DHIMBSHME? (È doloroso?)

Jo. Gjilpëra futet pas kryerjes së anestezisë lokale.

A DO TË MARRË PJESË AKTIV? (Parteciperò attivamente?)

Po. Humbja e ndjeshmërisë ndaj dhimbjes nuk përjashton perceptimin e kontraktimeve dhe shtytjen dhe nuk e zvogëlon forcën e dëbimit.

Përkundrazi: kontrolli i dhimbjes mund të lejojë pjesëmarrjen tuaj dhe një bashkëpunim më të qetë.

MUND TË NDRYSHOJ MENDJEN? (Posso cambiare idea?)

Po. Ju mund të tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë, edhe nëse kateteri është vendosur tashmë: thjesht pezulloni administrimin e barnave.

A DUHET TË QËNDROJ NË KREVAT? (Dovrò stare a letto?)

Jo. Përveç periudhave të shkurtra të vëzhgimit pas administrimit të barnave, ju do të mund të lëvizni lirshëm.

DO TA KEM AFËRË MAMINË APO GJINEKLOGEN? (Avrò vicino l'ostetrica o il ginecologo?)

Po. Analgjezia do të kryhet nga anesteziologu direkt në bllokun e dhomës së lindjes, me të gjithë ekipin në dispozicionin tuaj.

VIZITA E ANESTEZOLOGJISË (La visita anestesologica)

Vizita anesteziologjike ka një rëndësi të madhe për sigurinë e nënës, fëmijës dhe anestezistit që më pas do të duhet të kryejë procedurën. Mund të bëhet nga java e 36-të e shtatzënisë

dhe mund të rezervohet duke telefonuar në Centro Unico Prenotazioni, të pajisur me kërkesën e mjekut dhe kartën e shëndetit.

Me këtë rast, anesteziisti, në fund të mbledhjes, do të kërkojë pëlqimin e informuar për procedurën e dakorduar (të kërkuar me ligj).

Në vizitën anesteziologjike sillni me vete:

- analizën të përgjithshme të gjakut, duke përfshirë numrin e trombociteve dhe profilin e koagulimit (PT, PTT, INR dhe fibrinogjen);
- të gjitha analizat e kryera gjatë shtatzënisë;
- referimi nga mjeku i përgjithshëm ose gjinekologu për “Vizitë terapeutike antalgjike – Pyetje: shtatzëni”;
- çdo dokumentacion me rëndësi klinike përpara shtatzënisë.

Kursi përgatitor (Corso preparto)

Skanoni kodin QR dhe ndiqni lidhjen për të parë një video tutorial mbi lehtësimin e dhimbjes gjatë lindjes.

Dokumenti është hartuar nga një grup profesional i Njesisë Operative dhe Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun.
Përditësimi i prillit 2023